



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Prefekti Qarkut Fier

Nr. 1258 Prot.

Datë, më 17 / 11 / 2025

Nr. 4377 Prot.

Fier, më 13/11/2025

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të akteve administrativ

PREFEKTIT TË QARKUT - FIER

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3.b e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”. kërkojmë nga ana Juaj :

♦ **“Shpalljen Publike”** për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të gjashtë akteve administrativ – si vijon :

- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.101, me nr.3246/5 Prot., datë 30/10/2025, i materializuar për subjektin “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier (Lagjja “Kryengritja e Fierit”, (Truall+Ndertese)ish U.M.B me nr.Pasurie 8/133, ZK 8531).
- Vendimi i ndërmjetëm nr.3246/6 Prot., datë 30/10/2025, i materializuar për subjektin “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier (Lagjja “Kryengritja e Fierit”, (Truall+Ndertese)ish U.M.B me nr.Pasurie 8/133, ZK 8531).
- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.100, me nr.3221/4 Prot., datë 30/10/2025, i materializuar për subjektin “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, me seli në Lushnjë (Lagjja Karbunare e poshtëme, Zona Kadastrale Nr.2087, Nr.656/12).
- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.102, me nr.4198/1 Prot., datë 30/10/2025, i materializuar për subjektin “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1).
- Vendimi i ndërmjetëm nr.4198/2 Prot., datë 30/10/2025, i materializuar për subjektin “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1).
- Vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore (vendimi i sekuestros) Nr.4294 Prot., datë 10/11/2025, i materializuar për subjektin “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1), me administrator z.WU XUEYAN.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike. Bashkëngjitur, gjeni kopje origjinale të tetë akteve të lartcituara - gjithsej 9 (nëntë) fletë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 3246/1 Prot.

Fier, më 30/10/2025

VENDIM Nr. 101

Sot, më datë 30/10/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022523, nr.3246/1 Prot., datë 29.09.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier (Lagjia "Kryengritja e Fierit", (Truall+Ndertese)ish U.M.B me nr.Pasurie 8/133, ZK 8531), si dhe praktikën doganore,

KONSTATOVA SE:

Subjekti "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 9446/1, datë 30.03.2022. Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk është dorëzuar në degën doganore mbikqyrëse Aneksi nr.8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230 të Kodit Doganor, edhe pse subjekti është njoftuar nga Dega e Doganës.

Midis të tjerave, në Udhëzimin nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv", është parashikuar si detyrim për operatorin ekonomik si vijon "...Të kryejë një bilanc tre mujor në formën e akt rakordimit në bashkëpunim me doganierin që ndjek regjimin".

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), përcaktohet qartë që : *"Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ"*.

Subjekti "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P ka kryer shkelje administrative të kryer në neglizhencë, bazuar në nenin 252, pika c) e Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i cili parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;*

Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 252, 257/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Subjekti “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier, është i detyruar të zbatojë me rigorozitet Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin Nr.04, datë 28.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 3246/6.....Prot.

Fier, më 30/10/2025

V E N D I M

Vendim i ndërmjetëm për rivlerësimin e klasifikimit të shkeljes doganore dhe vijimin e hetimit administrativ

Sot, më datë 30/10/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022522, nr.3246 Prot., datë 29.09.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier (Lagjja "Kryengritja e Fierit", (Truall+Ndertese)ish U.M.B me nr.Pasurie 8/133, ZK 8531), si dhe praktikën doganore,

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P, ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 9446/1, datë 30.03.2022.

Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore ndaj subjektit është evidentuar një shkelje doganore, e cila është pasqyruar në proces-verbalin e shkeljes, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon: *"Subjekti 'SILVER BLU Production' i pajisur me autorizim të Regjimit të Përpunimit Aktiv nr.9446/1 datë 30.03.2022, ka gjendje mall lëndë të parë pa i dhënë destinacion brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit, të parashikuar nga Ligji nr.102/2014 dhe Udhëzimi nr.04 'Mbi zbatimin praktik të RPA'. Kjo shkelje klasifikohet sipas neneve 250/1/a dhe 252/2/c dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të Ligjit nr.102/2014 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë'."*

Nga ana e grupit të kontrollit, subjekti është shpallur përgjegjës për detyrimin e shmangur në shumën 407,875 (katërqind e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, si dhe është penalizuar në masën e dyfishit të detyrimit doganor të shmangur, në shumën 815,750 (tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.

Proces-verbali i shkeljes doganore i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 3246/2 prot., datë 29.09.2025, si dhe me lajmërim publik. Nga përmbajtja e proces-verbalit rezulton se shkelja është klasifikuar nga grupi i kontrollit si kundërvajtje administrative, në kuptim të neneve 250/1/a dhe 252/2/c të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të po këtij ligji.

Megjithatë, nga përmbajtja e proces-verbalit dhe nga të dhënat në dosje nuk rezulton e verifikuar në mënyrë të dokumentuar gjendja fizike e mallrave, nëse ato ndodhen realisht në magazinat/ambientet e subjektit apo janë larguar prej tyre pa u dhënë destinacion doganor.

Në rast se mallrat, objekt i regjimit të përpunimit aktiv, nuk ndodhen më në magazinë dhe janë larguar jashtë vëzhgimit doganor pa autorizim, atëherë shkelja përmbush elementët e veprës së kontrabandës, sipas nenit 268 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, dhe nuk mund të trajtohet si kundërvajtje administrative. Në të kundërt, nëse mallrat ndodhen ende në magazinë, shkelja do të vijojë të trajtohet si kundërvajtje administrative, siç është konstatuar nga grupi i kontrollit.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

1. Urdhërohet verifikimi fizik i mallrave objekt i proces-verbalit të shkeljes së lartcituar, për të përcaktuar gjendjen e tyre aktuale në magazinat e subjektit “SILVER BLU Production” sh.p.k, në prani të përfaqësuesve të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore dhe të subjektit.

2. Në varësi të rezultatit të verifikimit, të bëhet klasifikimi i shkeljes si më poshtë :

- Nëse mallrat ndodhen në magazinë → shkelja trajtohet si kundërvajtje administrative sipas neneve 250/1/a dhe 252/2/c të Kodit Doganor.
- Nëse mallrat nuk ndodhen në magazinë → procedimi të rikualifikohet si kontrabandë, në zbatim të nenit 268 të Kodit Doganor, me pasojat penale përkatëse.

3.Derisa të përfundojë verifikimi fizik, të pezullohet përkohësisht shqyrtimi administrativ i proces-verbalit të shkeljes.

4.Ky vendim i ndërmjetëm t’i njoftohet subjektit “SILVER BLU Production” sh.p.k me NUIS M22724402P dhe Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore për zbatim të menjëhershëm.

5. Zyra juridike të procedojë me kërkimin me informacion të detajuar për subjektin pranë organit tatimor.

6. Afati kohor pezullues është deri në përfundim të verifikimit fizik të mallit, detyrë e cila do të kryhet nga ana e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore, Brenda muajit Nëntor 2025.

7. Kundër këtij vendimi, palët në procedim administrativ, kanë të drejtën e ushtrimit të ankimit administrativ te Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, brenda 30 (Tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e tij.

KRYETAR

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 3221/4, ... Prot.

Fier, më 30/10/2025

VENDIM Nr. 100

Sot, më datë 30/10/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022521, nr.3221 Prot., datë 24.09.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, me seli në Lushnjë (Lagjja Karbunare e poshtëme, Zona Kadastrale Nr.2087, Nr.656/12), si dhe praktikën doganore,

KONSTATOVA SE:

Subjekti “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 10373/1, datë 26.05.2022. Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk është dorëzuar në degën doganore mbikqyrëse Aneksi nr.8 “Dokumenti i mbylljes së autorizimit”, brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230 të Kodit Doganor, edhe pse subjekti është njoftuar nga Dega e Doganës.

Midis të tjerave, në Udhëzimin nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, është parashikuar si detyrim për operatorin ekonomik si vijon “...Të kryejë një bilanc tre mujor në formën e akt rakordimit në bashkëpunim me doganierin që ndjek regjimin”.

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Subjekti “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K ka kryer shkelje administrative të kryer në neglizhencë, bazuar në nenin 252, pika c) e Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i cili parashikon si vijon : Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 252, 257/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Subjekti “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, me seli në Lushnjë, është i detyruar të zbatojë me rigorozitet Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin Nr.04, datë 28.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 4198/.....Prot.

Fier, më 30/10/2025

V E N D I M N r . 1 0 2

Sot, më datë 30/10/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022525, me nr.3252/2 Prot., datë 30.09.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "SIBCO" sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Fier (Lushnjë, Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1), si dhe praktikën doganore,

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti "SIBCO" sh.p.k, me NUIS M24203402O ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 14303/1, datë 26.09.2022. Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk është dorëzuar në degën doganore mbikqyrëse Aneksi nr.8 "Dokumenti i mbylljes së autorizimit", brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230 të Kodit Doganor, edhe pse subjekti është njoftuar nga Dega e Doganës.

Midis të tjerave, në Udhëzimin nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv", është parashikuar si detyrim për operatorin ekonomik si vijon "...Të kryejë një bilanc tre mujor në formën e akt rakordimit në bashkëpunim me doganierin që ndjek regjimin".

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), përcaktohet qartë që : "*Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ*".

Subjekti "SIBCO" sh.p.k, me NUIS M24203402O ka kryer shkelje administrative të kryer në neglizhencë, bazuar në nenin 252, pika c) e Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i cili parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;*

Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 252, 257/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, është i detyruar të zbatojë me rigorozitet Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin Nr.04, datë 28.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 4138/2...Prot.

Fier, më 30/10/2025

V E N D I M

Vendim i ndërmjetëm për rivlerësimin e klasifikimit të shkeljes doganore dhe vijimin e hetimit administrativ

Sot, më datë 30/10/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022524, me nr.3251/2 Prot., datë 29.09.2025; Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022522, me nr.3252/3 Prot., datë 30.09.2025; të mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "SIBCO" sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Fier (Lushnjë, Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1), si dhe praktikën doganore,

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti "SIBCO" sh.p.k, me NUIS M24203402O ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 14303/1, datë 26.09.2022.

Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore ndaj subjektit janë evidentuar dy shkelje doganore, të cilat janë pasqyruar në proces-verbalin e shkeljes të lartcitur, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon: "*Subjekti 'SIBCO' i pajisur me autorizim të Regjimit të Përpunimit Aktiv nr.14303/1 datë 22.09.2022, ka gjendje mall lëndë të parë pa i dhënë destinacion brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit, të parashikuar nga Ligji nr.102/2014 dhe Udhëzimi nr.04 'Mbi zbatimin praktik të RPA'. Kjo shkelje klasifikohet sipas neneve 250/1/a dhe 252/2/c dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të Ligjit nr.102/2014 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë'.*"

Nga ana e grupit të kontrollit, subjekti është shpallur përgjegjës për detyrimin e shmangur në shumën 58,219 (pesëdhjet e tetëmijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, si dhe është penalizuar në masën e dyfishit të detyrimit doganor të shmangur, në shumën 116,438 (njëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e katërqind e tridhjet e tetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.

Në proces-verbalin e shkeljes me nr.3252/3 Prot., datë 30.09.2025, në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon: "*Subjekti 'SIBCO' i pajisur me autorizim të Regjimit të Përpunimit Aktiv nr.14303/1 datë 22.09.2022, ka detyrime doganore për mosdhënie destinacion të pajisjeve dhe makinerive të cilat kanë marrë autorizim për përjashtim nga TVSH me vlerën 662.148 lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas nenit 252/2/c dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të Ligjit nr.102/2014 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë'.*"

Nga ana e grupit të kontrollit, subjekti është shpallur përgjegjës për detyrimin e shmangur në shumën 662,148 (gjashtëqind e gjashtëdhjet e dymijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë, si dhe është penalizuar në masën e dyfishit të detyrimit doganor të shmangur, në shumën 1,324,296 (një milion e treqind e njëzet e katërmijë e dyqind e nëntëdhjet e gjashtë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.

Proces-verbalet e shkeljes doganore i janë njoftuar subjektit me shkresën nr. 3254 prot., datë 30.09.2025, si dhe me lajmërim publik. Nga përmbajtja e proces-verbaleve rezulton se shkelja është klasifikuar nga grupi i kontrollit si kundërvajtje administrative, në kuptim të neneve 250/1/a dhe 252/2/c të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të po këtij ligji.

Megjithatë, nga përmbajtja e proces-verbalit dhe nga të dhënat në dosje nuk rezulton e verifikuar në mënyrë të dokumentuar gjendja fizike e mallrave, nëse ato ndodhen realisht në magazinat/ambientet e subjektit apo janë larguar prej tyre pa u dhënë destinacion doganor.

Në rast se mallrat, objekt i regjimit të përpunimit aktiv, nuk ndodhen më në magazinë dhe janë larguar jashtë vëzhgimit doganor pa autorizim, atëherë shkelja përmbush elementët e veprës së kontrabandës, sipas nenit 268 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, dhe nuk mund të trajtohet si kundërvajtje administrative. Në të kundërt, nëse mallrat ndodhen ende në magazinë, shkelja do të vijojë të trajtohet si kundërvajtje administrative, siç është konstatuar nga grupi i kontrollit.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

1.Urdhërohet verifikimi fizik i mallrave objekt i proces-verbalit të shkeljes së lartcitur, për të përcaktuar gjendjen e tyre aktuale në magazinat e subjektit “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M242034020 , në prani të përfaqësuesve të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore dhe të subjektit.

2. Në varësi të rezultatit të verifikimit, të bëhet klasifikimi i shkeljes si më poshtë :

- Nëse mallrat ndodhen në magazinë → shkelja trajtohet si kundërvajtje administrative sipas neneve 250/1/a dhe 252/2/c të Kodit Doganor.
- Nëse mallrat nuk ndodhen në magazinë → procedimi të rikualifikohet si kontrabandë, në zbatim të nenit 268 të Kodit Doganor, me pasojat penale përkatëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. **4294**..... Prot.

Fier, më 10/11/2025

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori - subjekti “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G, me seli në Lushnjë, ka ndaj Degës së Doganës Fier”.

Dega e Doganës Fier, me Vendimin e saj Nr. 90, me Nr.2158/7 Prot., datë 11/09/2025, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 239,363.2 (Dyqind e tridhjet e nëntëmijë e treqind e gjashtëdhjet e tre pik dy) lekë; si dhe penaltetin doganor në shumën 718,089.6 (Shtatëqind e tetëmbëdhjetëmijë e tetëdhjet e nëntë pik gjashtë) lekë, ndaj subjektit debitor “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1), me administrator z.WU XUEYAN, me status në Q.K.B “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr. 2158/8 Prot., datë 11/09/2025, me lëndë “Njoftim - Vendimi” si dhe me anë të lajmërimit publik.

Gjithashtu, me shkresën nr.4149 Prot., datë 31/10/2025, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore” Dega e Doganës Fier i ka kërkuar subjektit ekzkeutimin vullnetar të detyrimeve doganore.

Personi juridik debitor “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 90, me Nr.2158/7 Prot., datë 11/09/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr. 90, me Nr.2158/7 Prot., datë 11/09/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik “BLACK INVEST” sh.p.k, me NUIS M33928403G, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale 957,452.8 (Nëntëqind e pesëdhjet e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjet e dy pik tetë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr. 90, me Nr.2158/7 Prot., datë 11/09/2025, të Degës së Doganës Fier.

K R Y E T A R

Kosta Vjero

